

Dhuna në marrëdhëniet familjare dhe domosdoshmëria e sigurizimit të saj

Dr. Bajram Ibraj

Departamenti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Kolegji Universitar i Biznesit, Tiranë

E-mail: bibraj@kub.edu.al

<https://orcid.org/0009-0006-1006-5379>

Abstrakt

Kriminaliteti ka lindur së bashku me lindjen e shoqërisë njerëzore dhe ka vijuar rrugëtimin e tij deri në ditët e sotme. Por dhuna dhe kriminaliteti në marrëdhëniet familjare veçanërisht në Shqipëri është bërë një problem i madh shqetësues.

Institucioni i parë që Zoti krijoi në tokë ishte institucioni i familjes, por fatkeqësisht edhe krimi i parë në botë ka ndodhur në marrëdhëniet familjare, kur vëllai më i madh Kaini vrau, vëllain e tij më të vogël Abelin. Në këtë mënyrë ka vijuar krimi, kriminaliteti dhe dhuna në familjet dhe në marrëdhëniet familjare deri më sot.

Për herë të parë, u miratua në vitin 2006, ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", ligj i cili u ndryshua dhe u përmirësua më tej edhe në vitet 2008, 2010, 2018 dhe 2020. Pamvarësisht se janë ashpërsuar masat penale, përsëri dhuna në marrëdhëniet familjare ka pësuar rritje të frikshme. Ndërkohë, që dhuna dhe kriminaliteti në marrëdhëniet familjare është parandaluar, zbuluar, dokumentuar dhe luftuar sipas qeverisjes ligjore dhe dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Interes të veçantë për parandalimin dhe minimizimin e veprave penale për dhunën në marrëdhëniet familjare, paraqesin studimi i etiologjisë kriminale domethënë origjinës, burimit, shkaqeve dhe pasojave të dhunës në marrëdhëniet familjare; edukimi, ndërgjegjësimi dhe civilizimi i shoqërisë dhe marrëdhënieve familjare në vetvete; por edhe nëpërmjet qeverisjes ligjore dhe dhënies së drejtësisë penale nëpërmjet vendimeve të gjykatave. Ndërsa, nëpërmjet rritjes së rolit më aktiv të shoqërisë dhe shtetit të së drejtës, nevojitet të sigurohet siguri dhe mbrojtja më e mirë e marrëdhënieve familjare me qëllim parandalimin e dhunës ndaj saj.

Fjalë kyçe: *Dhuna, marrëdhëniet familjare, sigurizimi, vepra penale, mbrojtja.*

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është vlerësimi, trajtimi dhe hulumtimi i problematikave që lidhen me: dhunën në marrëdhëniet familjare; kriminalitetin në rritje në këtë drejtim; shtimin e dhunës ndaj femrave nga ana e bashkëshortëve të tyre, por jo vetëm; origjina, burimet, shkaqet dhe pasojat e kësaj dhune; përmirësimet ligjore dhe sanksionet penale ndaj autorëve të këtyre veprave penale; si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë dhe shtetit ligjor për të siguruar sigurimin dhe mbrojtjen e marrëdhënieve familjare në funksion të sigurimit të dinjitetit njerëzor dhe të barazisë gjinore.

Legjislacioni për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare është miratuar për herë të parë në vendin tonë në vitin 2006 me ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Më pas ky legjislacion ka pësuar disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.9669 datë 18.12.2006 nëpërmjet ligjeve; 47/2018, datë 23.07.2018; ku është shtuar, neni 7/1, Garancia për mbrojtjen, pika 1; dhe neni 13/1 "Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme"; ligjit 125/2020, ku derisa të vendosë gjykata, policia urdhëron nxjerrjen e dhunuesit nga banesa, kur viktimja jeton në të njëjtën banesë me dhunuesin, përveç rasteve kur dhunuesi është i mitur, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara; ligjit nr.35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", Neni 130/a "Dhuna në familje". Shprehemi se këto ndryshime e përmirësimet ligjore kanë ndikuar pozitivisht në parandalimin e dhunës në familje dhe në rritjen e ndëshkimit të autorëve të kryerjes së këtyre veprave penale, megjithëse ky kriminalitet mbetet në përmasa shqetësuese për shoqërinë dhe familjet shqiptare.

Në fokus të këtij punimi do të jenë: hyrje, burimet, shkaqet dhe pasojat e dhunës në marrëdhëniet familjare; dhuna në marrëdhëniet familjare për periudhën 2005-2024; vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për dhunën në marrëdhëniet familjare në periudhën 2011- 2024; domosdoshmëria e sigurizimit të marrëdhënieve familjare dhe roli i shtetit drejtësi dhe qeverisje ligjore për mbrojtjen e tyre dhe perfundime dhe rekomandime. Ky punim nëpërmjet dhënies së përgjigjes për pyetjen kërkimore, a është dhuna në marrëdhëniet familjare një problem shqetësues aktual, dhe, cila ka qënë politika penale ndaj veprave penale kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, kërkon të argumentojë rolin e shtetit ligjor, të shoqërisë dhe sistemit të drejtësisë penale për mbrojtjen e femrave nga dhuna dhe kriminaliteti me qëllim mbrojtjen dhe sigurizimin e sigurisë së këtyre marrëdhënieve familjare.

1. Burimet, shkaqet dhe pasojat e dhunës në marrëdhëniet familjare

Kriminologjia studion në vetvete edhe etiologjinë kriminale që ka të bëjë me shkaqet dhe faktorët e kriminalitetit, por për dhunën në marrëdhëniet familjare, por jo vetëm, një rëndësi primare përpara zbulimit të shkaqeve dhe pasojave të këtij krimi, do të lypet të kërkojmë, zbulojmë dhe të bëjmë pjesë të proceseve hetimore dhe gjyqësore edhe origjinën dhe burimet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Burimet e dhunës në marrëdhëniet familjare janë:

1.Struktura Patriarkale dhe Kultura e Nderit: -Struktura patriarkale e familjes shqiptare ushqen ide të dominimit mashkullor dhe nënshtrimit të grave; -Kultura e "nderit" dhe turpiti që lidhet me raportimin e dhunës.Në shumë zona të Shqipërisë, marrëdhëniet familjare janë ende të ndërtuara mbi modelin patriarkal, ku burri konsiderohet si "koka e familjes"dhe

gruaja si vartëse. Kjo ideologji e vjetër mbështet dhunën si një mjet kontrolli ndaj grave. "Në shumë raste, gratë e shohin dhunën si pjesë të zakonshme të jetës martesore dhe nuk e raportojnë për shkak të frikës nga stigmatizimi dhe përjashtimi social" (Gedeshi & De Soto, 2002, faqe, 57).¹⁴³

2. Patriarkalizmi dhe normat kulturore tradicionale¹⁴⁴

-Varfëria, papunësia dhe pabarazia ekonomike.¹⁴⁵ Situatat ekonomike të vështira shkaktojnë stres dhe tension në familje, që shpesh përshkallëzojnë në dhunë. Gratë që varen ekonomikisht nga partneri nuk raportojnë dhunën për shkak të frikës nga përjashtimi apo mbijetesë,¹⁴⁶

-Përdorimi i alkoolit dhe i substancave narkotike;¹⁴⁷ Konsumi i lartë i alkoolit është një faktor që shoqërohet shpesh me dhunën fizike e psikologjike në familje;

- Mungesa e ndërhyrjes institucionale dhe zbatimit të ligjit.¹⁴⁸

Mungesa e reagimit të duhur nga policia apo sistemi gjyqësor krijon pandëshkueshmëri. Frika se denoncimi nuk do sjellë mbrojtje reale ose do rëndojë situatën;¹⁴⁹

- Mosfunksionimi i mekanizmave të mbrojtjes dhe pandëshkueshmëria;¹⁵⁰ niveli i ulët i arsimit dhe mungesa e ndërgjegjësimit dhe e informimit.¹⁵¹ Niveli i ulët i arsimit, sidomos në zonat rurale, lidhet me tolerancën më të lartë ndaj dhunës. Mungesa e edukimit gjinor dhe mosndërgjegjësimi për të drejtat e grave;¹⁵²

- Trashëgimia e dhunës ndër breza dhe roli i modelimit në fëmijëri.¹⁵³ Fëmijët që rriten në mjedise të dhunshme shpesh e konsiderojnë dhunën si mënyrë normale për zgjidhjen e konflikteve dhe mund ta përsërisin atë në jetën e tyre të rritur,¹⁵⁴ etj. Burimet e krimit dhe kriminalitetit në tërësi, nuk trajtohen pothuajse fare në jurispondencën tonë dhe shpesh burimet i klasifikojnë si shkaqe ose nuk arrijnë dot të dallojnë cilat janë burimet dhe cilat janë shkaqet e dhunës, por jo vetëm.

Shkaqet e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Sipas Jonathan Herring në librin e tij, "E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale", "Problemi i shkakësisë është një çështje ligjore, praktika gjyqësore duket se i zbaton rregullat në mënyrë efikase.¹⁵⁵ Ndërkohë, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në nenin 13: parashikon lidhja shkakësore.¹⁵⁶ Shkenca e kriminologjisë brenda saj trajton edhe shkencën e Etiologjisë kriminale e cila ka të bëjë me shkaqet dhe faktorët e kriminalitetit. Por, Ne duhet të shpjegojmë më tej se: "Detyra e etiologjisë është që t'u përgjigjet pyetjeve përse është kryer ose është bërë ndonjë sjellje ndëshkuese, për t'u gjetur shkakun i vërtetë ose faktori kriminogjen, ose ato shkaqe që ndikojnë në shfaqjen, formësimin dhe realizimin përfundimtar të sjelljes ndëshkuese si dukuri shoqërore dhe individuale, e ashtuquajtura

¹⁴³Gedeshi, I. & De Soto, H. (2002). Poverty in Albania: A Qualitative Assessment. World Bank.UNDP Albania (2016).

¹⁴⁴See, Gedeshi, I. & De Soto, H. (2002). World Bank.UNDP Albania (2016). *Gender Brief Albania*.

¹⁴⁵See, INSTAT & UN Women, Violence Against Women Survey in Albania, 2019, faqe 33.

¹⁴⁶Po aty.

¹⁴⁷See World Health Organization (WHO), 2014). Global status report on alcohol and health.

¹⁴⁸See OSBE (2022). Survey on Violence against Women in Albania.

¹⁴⁹Po aty.

¹⁵⁰Po aty, faqe 41.

¹⁵¹See UNICEF Albania (2020). Knowledge, Attitudes and Practices on Gender-Based Violence.

¹⁵²Po aty.

¹⁵³See Save the Children Albania (2018). Children's Experiences of Violence in the Family, faqe 12.

¹⁵⁴Po aty.

¹⁵⁵Jonathan Herring "E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale", Parathënie, Spartak Ngjela, Botimi V/Volumi I, UET Press, Tiranë, tetor 2013, faqe 87.

¹⁵⁶Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.7895, me datë 27.01.1995, neni 13.

*kriminogjenezë.*¹⁵⁷ Por në çështjen e dhunës në marrëdhëniet familjare, “Nuk duhet të mendohet se kontributi i vetëm i feminizmit është nxjerrja në pah e shembujve të stereotipizimeve gjinore mes gjyqësorit dhe juristëve, (rastet e përdhunimeve janë plot), apo shembuj kur ligji në mënyrë të pajustificueshme i trajton femrat dhe meshkujt në mënyrë të ndryshme, (shtrëngimi mund të jetë një shembull i kësaj, për faktin se është i disponueshëm si mbrojtje për bashkëshortet, por jo për bashkëshortët).¹⁵⁸ “Përqasja ligjore lejon që problem i krimit të shihet si rezultat i veprimeve të njerëzve të këqij, në vend që të pranohet atë si produkt të një shoqërie të pabarabartë dhe përjashtuese” Problemi qëndron se, ajo që është normale dhe ajo që është jonormale, ajo që është shkak, dhe ajo që është kusht- është një çështje perspektive dhe gjykimi”. Për të përdorur një nga shembujt e vetë autorit (Alan Norrie, *Crime, Reason and History* (Cambridge:CUB,2001),137-40). (pak i modifikuar) (1985,35) efekti i urisë të një shteti të botës së tretë mund t’i duket një fshatari si pasoja e thatësisë, dhe një shoqate humanitare si rezultat i inefiçencës dhe korrupsionit të qeverisë...Çdonjëri nga këta faktorë të ndryshëm, mund të veçohet si shkak, dhe, ata që mbeten, mund të quhen kushtet në prapaskenë, secili mund të prezantohet si faktor “që bën diferencën”.¹⁵⁹ Por natyrshëm, lind pyetja.“Cili faktor “bën diferencën”,shkaqet më të thella” apo “shkaku imediat”?Nëse “shkaqet më të thella” (varfëria, diskriminimi racial, shpërdorimi i detyrës nga ana e policisë) janë pjesë e kushteve “normale” të jetës në Anglinë e shekullit të njëzet, për këtë arsye, a eskludohen ato nga vëmendja jonë se çfarë shkaktoi trazira?Ndoshta do të ishte e favorshme për ligjin, me theksin e tij tek individualja, nëse vërtet shkaqet e thella do të përjashtoheshin.”¹⁶⁰

Pasojat e dhunës në marrëdhëniet familjare. Është shumë e rëndësishme që, “për disa lloje veprash penale është e nevojshme të provohet se ai veprim ka shkaktuar një pasojë të caktuar”.¹⁶¹Pasojat e dhunës në marrëdhëniet familjare në Shqipëri janë të shumta dhe ndodhin në nivele të ndryshme, duke përfshirë aspekte fizike, emocionale, psikologjike dhe sociale. Dhuna familjare ka efekte të thella, jo vetëm për viktimat direkte, por edhe për fëmijët dhe për shoqërinë në tërësi. Ja disa prej pasojave kryesore që mund të ndodhin:

1.Pasojat fizike dhe shëndetësore: Plagë dhe Dëmtime fizike: Gratë dhe fëmijët që përjetojnë dhunë mund të përjetojnë plagë të rënda, thyerje kockash, dëmtime të brendshme, dhe lëndime të tjera që kërkojnë trajtim mjekësor. Probleme shëndetësore afatgjata: Dhuna mund të çojë në sëmundje kronike si dhe çrregullime të tjera shëndetësore, si dhimbje kronike, probleme me tretjen, dhe shtatzëni të paplanifikuara, duke përfshirë abortet e përsëritura.¹⁶²

2.Pasojat psikologjike dhe emocionale: Stresi Post-traumatik: Dhuna në familje është një shkak i zakonshëm për zhvillimin e çrregullimeve të stresit post-traumatik (PTSD), sidomos tek viktimat që janë përballur me dhunë të përsëritur. Kjo mund të ndikojë në funksionimin e përgjithshëm të individëve dhe të shkaktojë ankth, depresion dhe pasiguri. Përkeqësimi i vetëbesimit: Pasojat psikologjike të dhunës përfshijnë uljen e vetëbesimit dhe pasiguri, veçanërisht te gratë që përjetojnë abuzime emocionale dhe psikologjike. Ky faktor mund të ndikojë gjithashtu në aftësinë e individëve për t’u marrë me sfidat e jetës.¹⁶³

¹⁵⁷Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi, “Politika e Luftimit të Kriminalitetit “Juridica, Prishtinë, Kosovë, 2012, faqe 33.

¹⁵⁸Jonathan Herring “E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale”, Parathënie, Spartak Ngjela, Botimi V/Volumi I, UET Press, Tiranë, tetor 2013, faqe 60.

¹⁵⁹Po aty, faqe 132-133.

¹⁶⁰Po aty, faqe 133.

¹⁶¹Po aty, faqe 87.

¹⁶²“Domestic Violence Against Women in Albania: A National Survey”, UN Women & INSTAT (2019), faqe, 33-34.

¹⁶³“Impact of Domestic Violence on Mental Health”, Journal of Clinical Psychology, 2018, faqe, 567-569.

3.Pasojat sociale dhe ekonomike: Izolimi shoqëror: Viktimat e dhunës në familje shpesh ndihen të izoluar nga shoqëria dhe familja, duke pasur më pak mundësi për të marrë mbështetje apo për të kërkuar ndihmë. Papunësia dhe varfëria: Dhuna mund të ndikojë në mundësitë e punësimit, veçanërisht për gratë që janë të detyruara të qëndrojnë në marrëdhënie të dhunshme për shkak të varësisë ekonomike nga partnerët abuzues. Kjo ndikon në varfërinë afatgjatë të familjeve dhe pasigurinë ekonomike.¹⁶⁴

4.Pasojat në fëmijët dhe brezat e ardhshëm: Rreziku i përsëritjes së dhunës: Fëmijët që rriten në mjedise të dhunshme janë më të prirur të zhvillojnë sjellje agresive, si dhe mund të bëhen viktimat e dhunës në të ardhmen. Një pjesë e madhe e viktimave të dhunës janë gjithashtu dëshmitarë të dhunës, çka ka pasoja të rënda psikologjike dhe zhvillimore. Kërcënimi i zhvillimit emocional dhe social: Fëmijët që jetojnë në mjedise dhune shpesh kanë vështirësi në shkollë, kanë çrregullime të sjelljes dhe mund të zhvillojnë probleme të shëndetit mendor.¹⁶⁵

5.Pasojat ligjore dhe institucionale: Vështirësi në arritjen e drejtësisë: Dhuna në familje shpesh mbetet e paadresuar për shkak të ndëshkimit të dobët nga institucionet, mosbesimit të viktimave ndaj sistemit gjyqësor, dhe frikës së hakmarrjes nga abuzuesit. Mungesa e mbrojtjes efektive: Edhe pse ka përpjekje për të krijuar ligje dhe struktura mbrojtëse, pasojat e dhunës mund të jenë të gjata dhe të dëmshme për viktimat për shkak të zbatimit të paqëndrueshëm të ligjeve.¹⁶⁶

Dhuna në marrëdhëniet familjare në Shqipëri ka pasoja të rënda për individët dhe shoqërinë në përgjithësi. Ajo ndikon në shëndetin fizik dhe mendor të viktimave, përkeqëson cilësinë e jetës, dhe ka pasoja të thella për fëmijët dhe brezat e ardhshëm. Për të adresuar këto pasoja, është e rëndësishme që të ndërmerren masa të forta nga autoritetet shtetërore dhe organizatat shoqërore për të mbështetur viktimat dhe për të parandaluar përhapjen e dhunës.

2. Dhuna në marrëdhëniet familjare për periudhën 2005-2024

Më poshtë, paraqesim tabelën 1, ku pasqyrohen statistika për dhunën në familje për periudhën 2005-2024, Tiranë.

Viti	Raste të evidentuara të dhunës në familje	Kërkesë-padi për UMM/ UM të plotësuar nga Policia e Shtetit	Procedime sipas Nenet 130/a të Kodit Penal	Persona të arrestuar per nenin 130/a "Dhune ne familje" të Kodit Penal	Vrasje në familje/raste viktimat/gra
2005	94				
2006	204	-			
2007	275	-			
2008	822	377			22
2009	1217	841			16
2010	1998	1234			20
2011	2181	1345			30
2012	2526	1562			28
2013	3020	1851			26/28
2014	4121	2422	1120	439	17/22
2015	3866	2148	1300	588	18/20
2016	4163	2207	1488	742	16/17
2017	4543	2593	1412	654	13/14
2018	4951	3037	1373	608	11/20/
2019	4629	2836	1341	535	14/17
2020	4701	2816	1505	615	6/7/

¹⁶⁴"Poverty and Domestic Violence in Albania: A Sociological Perspective", 2020, faqe, 42-44.

¹⁶⁵"The Cycle of Violence: A Study on Children Exposed to Domestic Violence" Albania, 2019, faqe, 12-15.

¹⁶⁶"Justice and Domestic Violence in Albania: Gaps and Challenges", OSCE Report, 2021, faqe, 8-9.


2021	5312	3266	1631	638	16/16/
2022	5214	2940	1887	683	10/12/
2023	5064	2730	1911	699	11/13/
2024	5445	2934	2139	844	10/10/
2005 -2024 30 vite	64.346	37.139	17.107	7.045	284 vrasje / 196 viktima, gra

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, <https://asp.gov.al>.

Përpunimi i autorit, qershor 2025.

Tabela 1. Statistikat për dhunën në familje për periudhën 2005-2024

Sipas të dhënave tabelare rezultojnë se për periudhën 2005-2024, për 30 vite, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, janë evidentuar statistikat për dhunën në familje si vijon: Raste të evidentuara të dhunës në familje, 64.346, kërkesë-padi për UMM/UM të plotësuar nga Policia e Shtetit, 37.139; Procedime sipas Nenit 130/a të Kodit Penal, 17.107; Persona të arrestuar për nenin 130/a "Dhunë në familje" të Kodit Penal, 7.045 dhe Vrasje në familje gjithsej 284 vrasje, raste viktima/gra, gjithsej 196. Këto statistika tregojnë rastet e shumta dhe në rritje të vazhdueshme të krimit në marrëdhëniet familjare. Më poshtë, paraqesim grafikun 1, ku jepet ecuria e rasteve të dhunës në familje në Shqipëri (2005-2024).



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, <https://asp.gov.al>.

Përpunimi i autorit, qershor 2025.

Grafiku 1. Ecuria e rasteve të dhunës në familje në Shqipëri (2005-2024)

Sipas grafikut 1, rezultojnë se për periudhën 2005-2024, rastet e evidentuara të dhunës në familje, në vitin 2005-2007 kanë qënë në një rritje të lehtë, ndërsa nga viti 2008 deri në vitin 2024 ato janë rritur maksimalisht, po kështu edhe kërkesë-padi për UMM/UM të plotësuar nga Policia e Shtetit. Ndërsa procedimet sipas Nenit 130/a të Kodit Penal dhe arrestimet janë rritur nga viti 2013 deri në vitin 2024. Rritja e rasteve të evidentuara është shumë e dukshme pas vitit 2008. Nga krahasimi i statistikave për 10 vitet e fundit 2015-2024, rezultojnë se kërkesat për padi përbëjnë rreth 54-61% të rasteve të evidentuara në 10 vitet e fundit. Procedimet penale janë rritur në përqindje pas vitit 2020, duke kaluar 35-39% në vitet e fundit. Arrestimet janë gjithashtu në rritje por përbëjnë vetëm rreth 12-15% të totalit të rasteve. Vrasjet përbëjnë një përqindje shumë të ulët (rreth 0.2-0.5%), por janë tregues të rëndë të dhunës ekstreme.

3. Vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për dhunën në marrëdhëniet familjare në periudhën 06.04.2011 – 07.03.2024.

Pranë, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, studjova vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për periudhën 06.04.2011-07.03.2024, dhe për rrjedhojë edhe vendimet e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të Përgjithshëm. Përmbajtja e këtyre vendimeve të marra nga trupi gjykues japin një panoramë të përgjithshme, mbi bazën e të cilave trajtohet dhe analizohet drejtësia penale. Më poshtë, paraqesim tabelën 2. ku jepen vendime të Gjykatave të Shkallës së Parë në rrethe dhe vendime të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 2011-2024.

Vendimi	Vepra Penale	Vendimi i Shkallës së Parë	Vendimi i Apelit
Nr. 417/2011	Vrasje, armëmbajtje pa leje	20 vjet + 1 vit burg	Lënë në fuqi
Nr. 114/2022	Vrasje familjare	Burg i përjetshëm dhe 35 vjet	Lënë në fuqi
Nr. 30/2023	Dhuna në familje	10 muaj burg	Lënë në fuqi
Nr. 871/2023	Vrasje familjare	25 muaj burg	Dënimi rritur në 22 vjet
Nr. 3319/2023	Dhuna, kanosje, armëmbajtje	6 vjet burg	Ule në 5 vjet e 4 muaj
Nr. 30-5876/2023	Dhuna + Keqtrajtimi i të miturit	16 muaj burg	Ankimi nuk pranohet
Nr. 30-6040/2023	Dhuna në familje	2 vjet e 6 muaj	Ule në 1 vit e 10 muaj
Nr. 30-7363/2023	Dhuna në familje	2 vjet burg	Ule në 1 vit e 8 muaj
Nr. 30-6500/2023	Dhuna + Veprime kundër vendimit	1 muaj e 10 ditë	Lënë në fuqi
Nr. 30-7918/2023	Dhuna në familje	16 muaj burg	Ankimi nuk pranohet
Nr. 30-328/2024	Dhuna në familje	8 muaj burg	Ankimi nuk pranohet
Nr. 30-1225/2024	Dhuna në familje	1 vit e 8 muaj	Lënë në fuqi
Nr. 30-1702/2024	Dhuna në familje	Dënim i pa specifikuar	Lënë në fuqi

Burimi: Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, <https://gjykata.gov.al/apel-pergjithshem> Përpunimi i autorit, 5 qershor 2025.

Tabela 2. Tabela krahasuese e vendimeve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 2011-2024.

Nga të dhënat e tabelës krahasuese të vendimeve të mësipërme si dhe studimi dhe analizimi në detaje i përmbajtjes së tekstit të vendimeve, analizës së fakteve, provave dhe analizës ligjore, kjo analizë krahasuese përmbledh dhe krahason vendimet e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, duke u fokusuar në llojet e veprave penale, ankimimet, vendimet përfundimtare dhe arsyetimin e gjykatës. Analiza mbulon çështjet nga viti 2011 deri në vitin 2024 dhe përfshin raste të vrasjeve, dhunës në familje, armëmbajtjes pa leje dhe keqtrajtimit të të miturve, dhe i'u referohet drejtpërdrejt fakteve, kërkesave dhe vendimeve të specifikuar në dosjen e ofruara, duke shpjeguar qasjen e gjykatës në vlerësimin e rrethanave, në reagimin ndaj ankimeve, si dhe në konsistencën ligjore të vendimeve në të gjitha nivelet.

Klasifikimi i veprave penale dhe analizë krahasuese e tyre. Vendimet e shqyrtuara mund të ndahen në dy kategori kryesore: - veprat penale të rënda: vrasje, armëmbajtje pa leje, vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare. - veprat penale me rrezikshmëri më të ulët: dhuna në familje, keqtrajtim i të miturit, kanosje, veprime në kundërshtim me vendimet e gjykatës.

Vëzhgime specifike dhe arsyetimet e Gjykatës së Apelit. -Në veprat e rënda si vrasja dhe armëmbajtja pa leje, Apeli ka vlerësuar rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e pandehurit për shoqërinë. - Në veprat e dhunës në familje, Apeli ka marrë në konsideratë rrethana lehtësuese si: pendimi i thellë, normalizimi i marrëdhënieve familjare, gjendja ekonomike e pandehurit dhe fakti që viktimat ka kërkuar ndihmën e bashkëshortit. -Ankimet për ndryshimin e llojit të dënimit (pezullimi dhe vendosja në provë) janë refuzuar në shumicën e rasteve. -Në disa çështje, Gjykata e Apelit ka lehtësuar dënimin përmes aplikimit të uljes së 1/3 së dënimit. -Gjykata ka rritur dënimin në një rast të vrasjes familjare (vendimi 871/2023), duke e konsideruar veprën me rrezikshmëri shumë të lartë.

Grupimi i veprave penale sipas llojit. Nga analizimi i vendimeve të dërguara, veprat penale ndahen në dy kategori kryesore: 1. veprat penale të rënda: -Vrasje në rrethana të tjera cilësuese¹⁶⁷-vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare¹⁶⁸2.veprat penale të dhunës në familje dhe të ngjashme: - dhuna në familje e thjeshtë ose e përsëritur (Vendimet nga viti 2023-2024) - Kanosje, keqtrajtim i të miturit, veprime në kundërshtim me vendimet e gjykatës.¹⁶⁹

Vlerësimi i ankimeve dhe qëndrimi i Gjykatës së Apelit. -Vendimi nr. 417/2011: -Apeli la në fuqi vendimin e Shkallës së Parë, duke mbështetur plotësisht dënimin për vrasje dhe armëmbajtje pa leje, pavarësisht kërkesës së të pandehurit për pafajësi për veprën e vrasjes; -Vendimi nr.114/2022: - Apeli vlerësoi dënimin me burgim të përjetshëm dhe 35 vjet burg si të përshtatshëm, duke mos pranuar kërkesat për ndryshim të kualifikimit juridik dhe duke theksuar rrezikshmërinë e lartë të veprës penale; - Vendimi nr. 30/2023: -Apeli refuzoi kërkesën për ulje të dënimit për shkak të rrethanave familjare, duke e konsideruar vendimin fillestar të drejtë dhe proporcional; -Vendimi nr. 871/2023: - Apeli rriti dënimin nga 25 muaj në 22 vjet burgim, duke e rikualifikuar veprën si vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare dhe duke mos pranuar ankimimin për tronditje psikike; -Vendimi nr. 3319/2023: -Apeli pranoi pjesërisht ankimimin duke pushuar akuzën për kanosje dhe duke ulur dënimin total nga 6 vjet në 5 vjet e 4 muaj; - Vendimi nr. 30-6040/2023 dhe 30-7363/2023: -Në këto raste Apeli uli dënimin për shkak të pendimit dhe rrethanave lehtësuese, duke treguar fleksibilitet për dhunën në familje nëse ka tregues rehabilitimi; -Vendimi nr. 30-6500/2023: -Vendimi u la në fuqi plotësisht duke dënuar të pandehurin për dhunë dhe veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës, duke mos pranuar ankimimin e bërë për ulje dënimi; -Vendimet 30-7918/2023, 30-328/2024, 30-1225/2024, 30-1702/2024: - Në këto raste Apeli nuk pranoi ankimimet e të pandehurve, duke theksuar se vendimet e Shkallës së Parë ishin të mbështetura në prova të plota dhe rrethana të qarta ligjore.

Rrethana lehtësuese të pranuar dhe të refuzuara. - *Rrethana të Pranuar:* - Pendimi i thellë (p.sh. vendimet 30-6040/2023, 30-7363/2023)¹⁷⁰; -Normalizimi i marrëdhënieve me

¹⁶⁷ Vendimi nr. 417/2011 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹⁶⁸ Vendimet nr. 114/2022 dhe nr. 871/2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹⁶⁹ Vendimet nr. 3319/2023 dhe nr. 30-6500/2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

¹⁷⁰ Vendim nr. 30-6040/2023 dhe vendim nr. 30-7363/2023) i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

viktimit; - Gjendja e vështirë familjare dhe sociale. -*Rrethana të Refuzuara*: -Argumentimi i dehjes në momentin e veprës-Kërkesa për pezullim të dënimit dhe vendosje në provë pa prova të rehabilitimit - Pretendime të paqarta mbi mosprovimin e akuzës.

4. Domosdoshmëria e sigurizimit të marrëdhënieve familjare dhe roli i shtetit, drejtësisë dhe qeverisjes ligjore për mbrojtjen e tyre

Për të pasqyruar këtë çështje të rëndësishme është e domosdoshme të referohemi aspektit ligjor që lidhen me sigurizimin e marrëdhënieve familjare në funksion të parandalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare. Konventa e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, Konventa e Stambollit, 11.V.2011, parashikon në nenin 31-Kujdestaria, të drejtat e vizitave dhe siguria;¹⁷¹neni 43-Aplikimi i veprave penale.¹⁷²Ndërsa, Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore Romë, 4.XI.1950,¹⁷³ titulli I, të Drejtat dhe Liritë, neni 2-E drejta për jetën, ku pika 1, shprehet:E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.Neni 5, E drejta për liri dhe siguri, ku pika 1 shprehet:1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t’i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj.

Parimi i së drejtës së sigurisë. Mendimi i Kantit se asnjë nuk lejohet që t’i trajtojë të tjerët vetëm si mjete. Ky është imperativ kategorik, i vlefshëm për të gjitha rastet e bashkëveprimit midis njerëzve. Çfarë do të thotë të përdorësh një njeri si mjet? Në rastin më të keq do të thotë vrasje, dhunë dhe skllavëri. “Nëse e kthejmë vështrimin te trajtimi i grave që nga koha e egërsisë, teksa ato u nështroheshin mundimeve gjithfarësh dhe hanin ushqimin që mbetej, pasi kishin ngrënë burrat, pastaj në mesjetë, kur u shërbenim burrave në tryezë, e deri në ditët tona, kur, për të gjitha masat shoqërore që merren, me pretendimet e grave gjithmonë kanë përparësi, shohim se, sa më i keq ky trajtim, aq më i dobët është ndërgjegjësimi për këtë; ndërsa tani, që trajtohen më mirë se kurrë ndonjëherë, shpallja e pakënaqësive të tyre fuqizohet dita-ditës; dhe britmat më të forta të protestës, vijnë nga “parajsa e grave” nga Amerika.”¹⁷⁴

A nuk është edhe në të drejtën e Sigurisë që marrëdhënia primare konceptohet tipikisht ajo marrëdhënie midis shtetit dhe qytetarit? Pra, marrëdhënia midis qytetarit dhe shtetit... duhet të tërheqin vëmendjen e interesit të shtetit- *e drejta e Sigurisë* ka si objekt të saj sigurinë e shtetit dhe të qytetarëve.“ Strukturat e sigurisë do të duhet që në veprimtarinë e tyre të shtonin edhe Parimin e “minimizimit shkakësor”. Përvoja Britanike në të drejtën penale “Shkakësia: A duhet të kenë rëndësi pasojat?”, “Minimizimin shkakësor”, kufizimet e përfaqësues së shkakësisë, dhe aspekte të tjera në lidhje me shkakësinë.”¹⁷⁵ Kështu në testin për shkakun substancial dhe funksional, ***siguria jonë blihet me shpenzimet e lirisë së autorit***, dhe kështu që testi për shkakun substancial dhe funksional shkel parimin e

¹⁷¹1.Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që, në përcaktimin e kujdestarisë dhe të drejtave të vizitave të **fëmijëve**, të merren në konsideratë incidentet e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente. 2.Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të garantuar që ushtrimi i vizitave ose të drejta të tjera kujdestarie të mos rrezikojnë të **drejtat dhe sigurinë e viktimës ose fëmijëve**.

¹⁷²Veprat e përcaktuara në pajtim me këtë Konventë aplikohen pavarësisht nga natyra e marrëdhënies ndërmjet viktimës dhe shkelësit.

¹⁷³Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshuar me Protokollet Nr. 11, 14 dhe 15 shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16.

¹⁷⁴Herbert Spencer, “Njeriu kundër Shtetit”, Dita 2000, faqe 158-159.

¹⁷⁵Jonathan Herring “E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale”, Parathënie, Spartak Ngjela, Botimi V/Volumi I, UET Press, Tiranë, tetor 2013, faqe 121- 135.

barazisë.”¹⁷⁶ Autori, Jonathan Herring në librin, “E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale”, shprehet: “Duhet e Drejta Penale t’i ndëshkojë mosveprimet? Ka dy qasje të autorëve të ndryshëm në lidhje me këtë çështje. Kështu disa autorë i qëndrojnë pikëpamjes se: “ne duhet të jemi fajtorë në lidhje me çdo mosveprim. Ndërsa pikëpamja e disa autorëve të tjerë është se: “Mosveprimet nuk duhet të ndëshkohen në asnjë rast”. Por autori i këtij libri shprehet se: “Debati realisht qëndron se cilat mosveprime duhet të ndëshkohen”. Në këtë kuptim, lind pyetja se, cilat janë mosveprimet që duhet të ndëshkohen në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare. Le ti referohemi, Anthony Giddens “Sociologjia, 1997, i cili shprehet se: “Shtëpia shpesh përfytyrohet si qielli i sigurisë dhe i lumturisë, por *dhuna shtëpiake*, dhuna brenda shtëpisë, është pjesë e përvojës së shumë grave.”¹⁷⁷ Ndërsa, Viktor Hygo, duke folur për dhunën në familje dhe krimet kundër grave e femrave, në lidhje me fëmijëvrasjen, thotë: “Ah, mos e sulmoni kurrë gruan e cila është përkulur e molisur kush di se në çfarë barre është përmbytur ai shpirt i mjerë!”

Shteti ligjor dhe sigurizimi i dhunës në marrëdhëniet familjare është dhe do të jetë gjithmonë çështja më e rëndësishme për parandalimin dhe minimizimin e dhunës në marrëdhëniet familjare. Sipas autorëve Raino Malnes dhe Knut Midgaard, kërkohet “Shteti ligjor dhe njerëzit e drejtë”,¹⁷⁸ shteti i mirë-qeverisja me anë të ligjeve,¹⁷⁹ ku, “Qëllimi, gjithë rrugën, ka qenë gjetja e mënyrës së përkryer për të qeverisur një shtet dhe e parimeve që duhet të ndjekë një individ gjatë jetës së tij. (Ligjet, libri 3, faqe 702.) Aty ku ligji nuk gëzon autoritetin më të lartë, nuk ka legjislacion.¹⁸⁰ Pra, në radhë të parë, duhet *shteti ligjor*. Duhet të qeverisë ligji. Vendorsja e rendit bëhet e mundur vetëm në qoftë se rregullat për marrëdhënie midis njerëzve mbrojnë lirinë individuale.¹⁸¹ Prandaj, *Akti i Sigurizimit* të marrëdhënieve familjare është i domosdoshëm.

Shkolla e Kopenhagës ka zhvilluar një tërësi konceptesh thelbësore për të rishqyrtuar sigurinë, veçanërisht nëpërmjet nocioneve të saj të sigurizimit dhe de-sigurizimit. Shkolla e Kopenhagës argumenton se një problematikë mund të sigurizohet- pra, të inkuadrohet si çështje sigurie dhe të zhvendoset nga skaji i politizimit drejt atij të sigurizimit të spektrit-nëpërmjet një akti sigurizimi. Një aktor sigurizues (psh qeveria, ushtria, shoqëria civile) e artikulon një çështje, si kërcënim ekzistencial për një objekt referues. Sipas autorit Alan Collins në librin e tij me titull: “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, çështja e dhunës në marrëdhëniet familjare sugjeroi që të pozicionohet në skajin e sigurizuar të spektrit ku kërkon veprime urgjente përtej procedurave politike standarte të shtetit. Ndërsa, sipas autorëve Raino Malnes dhe Knut Midgaard, shprehen se: Familja është më e rëndësishme se anëtarët e familjes. Shteti është më i rëndësishëm se familja. Shteti vjen i pari, sepse njerëzve u duhet *ai* më shumë se gjithçka, për të jetuar ashtu siç duhet.¹⁸² Në qoftë se shtëpia, që duhet të jetë limani i sigurtë i njerëzve në furtunat e jetës, nuk është e tillë, ç’mund të themi për shoqërinë e qytetit?¹⁸³ Në radhë të parë, duhet *shteti ligjor* dhe duhet të qeverisë ligji. Qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe ... shteti ligjor

¹⁷⁶Po aty, faqe 129.

¹⁷⁷Anthony Giddens “Sociologjia, shtëpia botuese “Çabej”, Tiranë, Tetor 1997, faqe 187.

¹⁷⁸Raino Malnes, Knut Midgaard, “Filozofia Politike”, shtëpia botuese Rozafa, Prishtinë 2007, faqe 25-26.

¹⁷⁹Po aty, faqe 30-36.

¹⁸⁰Po aty, faqe 46.

¹⁸¹Po aty, faqe 274.

¹⁸²Po aty, faqe 63.

¹⁸³Po aty, faqe 70.

është i sigurtë vetëm në qoftë se i ka rrënjët te normat shoqërore.¹⁸⁴ Argumenti ishte dhe mbetet i thjeshtë: burrat kanë “kapur” shtetin, prandaj gratë duhet t’a rimarrin atë.¹⁸⁵

Përfundime dhe rekomandime

1. Kuadri ligjor kombëtar për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare që nga ligji i parë nr.9669, datë 18.12.2006“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”; dhe më pas me ndryshimet e përmirësimet ligjore të bëra në vitet 2008, 2010, 2018, 2020, kanë patur si qëllim: parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, si dhe garantimin e mbrojtjes të pjesëtarëve të familjes; forcimin e masave mbrojtëse dhe procedurale më të shpejta të viktimave dhe sidomos nëpërmjet Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme,(UMPMM) nga Policia e Shtetit apo nëpërmjet UMM/UM të lëshuar nga Gjykata; ashpërsimi i dënimeve; programet specifike të rehabilitimit për dhunuesit; zgjerimi i rrethit të subjekteve që përfitojnë mbrojtje nga ligji; si dhe u shtuan detyrat e autoriteteve përgjegjëse të linjës, për ngritjen e qendrave sociale dhe të rehabilitimit për viktimat dhe dhunuesit, ngritjen e strukturave e të qendrave publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;marrjen e masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve; marrjen e masave për zbatimin e vendimit gjyqësor, nga organet vendore të vendbanimit dhe/ose vendqëndrimit të viktimës.

2. Por, origjina dhe burimi i dhunës në familje ishte edhe mos plotësimi i kushteve të banesave sociale ku të strehohen personat dhe familjarët e dhunuar (në vitet 2006 dhe 2018 kur u miratua ligji dhe ndryshimet përkatëse, pra, për 12 vjet). Domethënë kur personat dhunohen në familje, shteti ka të drejtën e sigurisë së banesave sociale, por shteti këto nuk i ka siguruar. Atëherë çfarë ndodhi nga viti 2006 e deri më sot, kur pamvarësisht se ligji i 2018 shprehet për strehim të përkohshëm? Akoma nuk është zgjidhur. Kështu, femrat ankohen në polici për dhunën fizike e psikologjike të ushtruara ndaj tyre apo fëmijëve nga bashkëshorti dhe policia e shoqëron dhe e ndalon, por burri kthehet në banesë dhe gruan që e denoncoi në polici e ka në hyrjen përballë ose në dhomën që i ndan një koridor ose një mur i vetëm dhe ushtron përsëri dhunë, dhe pastaj gjykata e dënon me heqje lirie.

3. Dhuna shtëpiake, dhuna brenda shtëpisë, është pjesë e përvojës së shumë grave, prandaj dhuna në familje akoma nuk raportohet në të gjitha rastet, por përsëri është në rritje dhe është bërë një fenomen tepër shqetësues për familjarët, shoqërinë dhe shtetin.

4. Nga studimi, arrihet në përfundimin se: origjina dhe burimi i dhunës në marrëdhëniet familjare nuk trajtohen fare, prandaj ky punim i trajton ato. Ndërkohë që mjaftohet vetëm me trajtimin e shkaqeve dhe pasojave të tyre. Shpesh herë dhe jo rastësisht ngatërrohen burimi me shkakun e krimit, si dhe mbivendosen edhe shkaqet me pasojat duke i zënë vendin njëra -tjetrës.

5. Qëndrimi i gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatës së apelit për veprat e dhunës në familje ka rezultuar se:

- Kanë qenë përgjithësisht të rreptë në trajtimin e dhunës në familje, duke mos pranuar shumicën e ankimeve që kërkonin masa alternative të dënimit. Megjithatë, në rastet kur është provuar pendimi i sinqertë dhe ka pasur dëshmi për rregullim të marrëdhënieve, Apeli ka treguar fleksibilitet duke ulur dënimet;
- Gjykata ka refuzuar përdorimin e dehjes si rrethanë lehtësuese dhe ka vendosur dënime që synojnë të japin mesazhe parandaluese për shoqërinë.

¹⁸⁴ Po aty, faqe 273

¹⁸⁵Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, UET, 2010, faqe 114.

- Gjykata e Apelit ka treguar qëndrueshmëri në vlerësimin e veprave penale, duke ruajtur balancën mes rëndësisë së veprës, rrezikshmërisë së autorit dhe rrethanave lehtësuese. Në tërësi, veprat e rënda si vrasjet janë trajtuar me ashpërsi, ndërsa veprat e dhunës në familje janë gjykuar më fleksibël kur ka prova për pendim të thellë dhe rehabilitim.

- Nga analiza e hollësishme e vendimeve rezulton se Gjykata e Apelit ka ruajtur konsistencën në interpretimin e ligjit, duke bërë diferencimin e qartë mes veprave me rrezikshmëri të lartë dhe atyre me rrezikshmëri më të ulët. Në veprat penale të rënda si vrasjet, Gjykata ka qëndruar i prerë në mospranimin e ankimeve. Në veprat e dhunës në familje, ajo ka treguar balancë duke marrë në konsideratë rrethanat individuale dhe rrezikshmërinë sociale të pandehurit.

6. Sigurizimi i sigurisë së marrëdhënieve familjare është çështje emergjente. Prandaj, shteti duhet të marrë vendimin e “Sigurizimit të sigurisë të marrëdhënieve familjare” nëpërmjet aktit të sigurizimit, në mënyrë që të zbatohen masat për parandalimin e minimizimit të këtij kriminaliteti sa: primitiv, kafshëror i ashpër aq edhe i sofistifikuar me format moderne të dhunimit, prostituimit e trafikimit të vajzave dhe grave brenda e jashtë vendit.

7. Përveç veprimeve të ashpra të autorëve të veprave penale, lypet që edhe ndaj mosveprimeve të ndëshkohen në lidhje me dhunën në marrëdhëniet familjare. Për këtë, kërkohet të bëhet një studim i thelluar i vendimeve gjyqësore për dhunën në familje për periudhën 1990-2025, sepse duhet të nxirren edhe përfundime, konkluzione e rekomandime të vlefshme që lidhen edhe me origjinën, burimet e shkaqet shpesh të “*fshehura*” të ushtrimit të dhunës në marrëdhëniet familjare, të cilat në vetvete sjellin pasoja të rënda. Prandaj, duhet që nëpërmjet së Drejtës Penale, Policia e Shtetit nëpërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe Prokuroria nëpërmjet prokurorëve, si dhe gjykatat shqiptare t’i hetojnë deh gjykojnë këto aspekte “*të fshehura*” që bëhen shkaqe të dhunës në familje dhe të ndëshkojë edhe mosveprimet që anashkalohen dhe që nuk parandalojnë por përkundrazi e “*stimulojnë*” dhunën në marrëdhëniet familjare.

Bibliografia

- 1) Alan Collins, “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, UET, 2010.
- 2) Arta Mandro, Aurela Anastasi Mariana Semini, “Komentari i ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Tiranë, Shqipëri, Dhjetor 2021.
- 3) Jonathan Herring “E Drejta Penale, Teori, kazuse dhe materiale”, Parathënie, Spartak Ngjela, Botimi V/Volumi I, UET Press, Tiranë, Tetor 2013.
- 4) Vesel Latifi, Ismet Elezi, Vasilika Hysi, “Politika e Luftimit të Kriminalitetit “Juridica, Prishtinë, Kosovë, 2012.
- 5) Herbert Spencer, “Njeriu kundër Shtetit”, Dita 2000.
- 6) Anthony Giddens “Sociologjia, shtëpia botuese “Çabej”, Tiranë, Tetor 1997.
- 7) Raino Malnes, Knut Midgaard, “Filozofia Politike”, Prishtinë 2007.
- 8) Gedeshi, I. & De Soto, H. (2002), Poverty in Albania: A Qualitative Assessment. World Bank. UNDP Albania (2016).
- 9) INSTAT & UN Women, Violence Against Women Survey in Albania, 2019.
- 10) World Health Organization (WHO, 2014). Global status report on alcohol and health.
- 11) OSBE (2022). Survey on Violence against Women in Albania.
- 12) UNICEF Albania (2020). Knowledge, Attitudes and Practices on Gender-Based Violence.

- 13) Save the Children Albania (2018). Children's Experiences of Violence in the Family.
- 14) "Impact of Domestic Violence on Mental Health", Journal of Clinical Psychology, 2018.
- 15) "Poverty and Domestic Violence in Albania: A Sociological Perspective", Albanian Sociological Review, 2020.
- 16) "The Cycle of Violence: A Study on Children Exposed to Domestic Violence", 2019.
- 17) "Justice and Domestic Violence in Albania: Gaps and Challenges", OSCE Report, 2021.
- 18) Ligj nr. 104/2012 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", Stamboll, 11.V.2011.
- 19) Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndryshuar me Protokollet Nr. 11, 14 dhe 15 shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12, 13 dhe 16.
- 20) Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje" CAHVIO, ratifikuar më 4 shkurt 2013.
- 21) Ligji nr.35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- 22) Ligj nr. 23/2012, datë 1.3.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 17, ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.144, datë 2.5.2013, neni 33.
- 23) Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.
- 24) Ligji nr.9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare" (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr.10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr.125/2020, datë 15.10.2020) (I përditësuar).

Vendime te gjykatave:

- 1) Vendimi nr. 417/2011 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 2) Vendim nr. 114/2022 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 3) Vendim nr. 871/2023, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 4) Vendim nr. 3319/2023 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 5) Vendim nr. 30-6500/2023, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 6) Vendim nr. 30-6040/2023 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 7) Vendim nr. 30-7363/2023 i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 8) Vendim nr. 30-7918/2023, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 9) Vendim nr. 30-328/2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 10) Vendim nr. 30-1225/2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- 11) Vendim nr. 30-1702/2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Materiale në internet:

www.coe.int/conventionviolence.